



# 2022

## RAPORT – TM4-2022



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR”

SH.A

Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

[www.hidroregjioni-jugor.com](http://www.hidroregjioni-jugor.com)


## PËRMBAJTJA

<b>Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”</b>		<b>4</b>
<b>I.</b>	<b>RAPORTI I DEPARTAMENTIT TEKNIK</b>	<b>5</b>
<b>1.1</b>	<b>Performancat</b>	<b>5</b>
1.1.1	Situata e furnizimit – TM4 - 2022	5
1.1.2	Aktivitetet kryesore	6
1.1.3	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	11
1.1.4	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	12
1.1.5	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	12
<b>II.</b>	<b>RAPORT I DEPARTAMENTIT RAJONAL PËR KONSUMATORË</b>	<b>13</b>
<b>2.1</b>	<b>Performancat</b>	<b>13</b>
2.1.1	Numri i Konsumatorëve – TM4-2022	13
2.1.2	Faturimi m <sup>3</sup> - TM4-2022	14
2.1.3	Faturimi €- TM4-2022	15
2.1.4	Arkëtimi €- TM4-2022	16
<b>2.2</b>	<b>Komentet kryesore nga DPK- TM4 - 2022</b>	<b>17</b>
2.2.1	Aktivitetet kryesore- TM4 - 2022	17
2.2.2	Raport i ankesave teknike dhe komerciale	17
2.2.3	Raport i Ekipes së inspektimit dhe shqyçjes	17
2.2.4	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	18
2.2.5	Masat e realizuara/ mos realizuara nga periudha paraprake	18
2.2.6	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	19
<b>III.</b>	<b>RAPORT I DEPARTAMENTIT FINANCIARË</b>	<b>20</b>
<b>3.1</b>	<b>Aktivitetet kryesore – TM4 - 2022</b>	<b>20</b>
3.2	Arsyeshmëria e shpenzimeve – TM4 - 2022	21
3.3	Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe	22
3.4	Masat e realizuara nga periudha paraprake	23
3.5	Masat e propozuara për periudhën në vazhdim	23
3.6	Transaksionet kryesore	26

<b>IV.</b>	<b>RAP. I DEPARTAMENTIT ITUN</b>	<b>27</b>
4.1	Fushëveprimtaria- ITUN	27
4.2	Statusi i projektit – masat shoqëruese	
4.3	Aktivitet kryesore	
4.4	Problemet e evidentuara	31
4.5	Masat e realizuara/ mos realizuara	31
4.6	Masat e propozuara	32
<b>V</b>	<b>RAP. I DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS</b>	<b>33</b>
<b>VI</b>	<b>RAP. I AUDITORIT TË BRENDSHËM</b>	<b>43</b>
<b>VII</b>	<b>RAP. I ZYRES SË PROKRIMIT</b>	<b>45</b>
	<b>ORGANOGRAMI</b>	<b>48</b>

## ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A KRU" HIDROREGJIONI JUGOR" Sh.A Prizren

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit, viti 2022



LEGJENDA:	
05	Zona e shërbimit
05	Qytetet me ujë
75	Fshatrat me ujë që menaxhohen nga HRJ
118	Venbanimet pa shërbime të ujësjellësit

Punoi: Shërbimi TEKNIK


## I. RAPORT I DEPARTAMENTIT TEKNIK

### 1.1 PERFORMANCAT - KRU „ HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A – PRIZREN

#### PRODHIMI – TM4 2022

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

TM1-TM2-TM3-TM4- 2022								
K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN								
PRODHIMI - m3								
NJËSIA PUNUESE	TM1-2022		TM2-2022		TM3-2022		TM4-2022	
	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3	l/sec	m3
PRIZREN	313.8	2,440,100	379.9	2,987,000	454.7	3,574,850	333.6	2,622,600
SUHAREKË	79.3	616,252	91.4	718,300	103.6	814,302	82.6	649,421
MALISHEVË	42.2	328,179	47.4	372,577	46.7	367,375	46.2	363,633
DRAGASH	32.8	255,294	31.0	244,063	33.3	262,134	29.9	234,812
<b>TOTAL</b>	<b>468.1</b>	<b>3,639,825</b>	<b>549.7</b>	<b>4,321,940</b>	<b>638.3</b>	<b>5,018,661</b>	<b>492.3</b>	<b>3,870,466</b>
NDRYSHIMI l/sec			21.63	682,115	88.61	696,721	(146.04)	(1,148,195)
NDRYSHIMI %				18.74%		16.12%		-22.88%



### 1.1.1 SITUATA E FURNIZIMIT

Furnizimi i konsumatorëve me ujë të pijes për muajt Tetor-Dhjetor të vitit 2022, në nivel regjional, duke përfshirë të gjitha njësitë punuese e operuese, ka qenë i plotë dhe i rregullt me përjashtime të vogla dhe të pjesshme të furnizimit në disa lokalitete nga ndërprerjet e energjisë elektrike apo problemeve të natyrshme të shfaqura në puset furnizuese. Furnizimi stabil dhe i kënaqshëm vije si rezultat i kushteve të volitshme atmosferike për resurset dhe kapacitetet ujore sikurse dhe investimeve të vazhdueshme në pëmirësimin e rrjetit në përgjithësi me theks të veçantë në zonat problematike të furnizimit.

Në muajt Tetor-Dhjetor, kemi realizuar furnizimin stabil, kualitativ dhe kuantitativ duke përmbushur standardet aplikative për furnizim 24h dhe cilësi 100 % të ujit të pijes dhe duke ndërmarrë në vazhdimësi aktivitetet e duhura në operim dhe mirëmbajtje për funksionim optimal të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit.

### 1.1.2 AKTIVITETET KRYESORE

Angazhimet dhe menaxhimet e përditshme të punëve komfor detyrimeve dhe përgjegjësi të vendit të punës dhe jashtë tyre për operimin dhe funksionimin optimal të Departamentit Teknik në veçanti dhe Kompanisë në përgjithësi.

Takimet e rregullta ditore, javore dhe mujore të menaxhmentit, me bashkëpunëtorët, me udhëheqësit e njërive punuese dhe shërbimet tjera të Kompanisë.

Takimet me institucionet komunale, qeveritare, me institucione financiare donatore, me konsumatorë etj.

Takimet dhe shkëmbimet e informacioneve dhe të dhënave me ARRU, Institutin Metrologjik, KNMU, sektorët e ujit dhe energjisë dhe Institucionet e agjensionet e ndërlidhura drejtpërdrejt apo indirekt me monitorimin e Kompanisë dhe të tjera të ngjashme në funksion të përgjegjësi dhe përmbushjes së detyrimeve karshi standardeve operuese aplikative.

Kontributit në cilësinë e anëtarit të Komitetit Teknik të Konferencës së ujit – Nëntor 2022 për përzgjedhjen dhe selektimin e abstrakteve dhe projekteve prezantuese dhe moderimi i sesionit teknik.

Raportet e rregullta për menaxhmet, KE, BD, ARRU dhe Institucionet tjera monitoruese dhe ndërvepruese me Kompaninë.

Përgjigjet dhe shkëmbimet e shkresave përmes komunikimeve elektronike e fizike.

Aplikimi dhe procedimi i kërkesave, ankesave dhe shkresave zyrtare që lëshon DT - Përgjigjeve në kërkesa, Dhënia e kushteve teknike, Lejeve, Vendimeve dhe Pëlqimeve, komfor Rregulloreve të zbatueshme të Kompanisë.

Menaxhimi i projekteve të investimeve kapitale sipas planifikimeve të PB 2022 të përfunduara dhe ato në realizim e sipër dhe projekteve e aktiviteteve tjera investive e operative komfor kërkesave dhe nevojave të shfaqura nga shërbimet e kompanisë, konsumatorët dhe institucionet tjera si objektiv konsistent në avancimin e funksionimit dhe efikasitetit të Kompanisë. Rreth 33 aktivitete investive kapitale të përfunduara apo në finalizim e sipër.

Harmonizimi i projekteve investive dhe dokumentacioneve përkatëse teknike me të gjitha Institucionet financiare komunale, vendore e tjera, përpilimi dhe finalizimi i projekt propozimeve te përgatitura nga DT.

Procedimi, monitorimi dhe kontributi në mbarëvajtjen e Marrëveshjeve bashkë investimi të hartuara dhe menaxhuara me komunën e Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit pjesërisht të përfunduara dhe disa prej tyre në ekzekutim e sipër të evidentuara si në vijim:

Projekti studimor dhe investiv për furnizim me ujë të pijes për Prizrenin nga burimet Vërmica, Poslishti dhe Sozi – Nashec – 100,000.00 €.

Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në rr. „Edit Durham “ – Prizren – 634,000.00 €.

Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në rr; „Nëna Tereze “ – Prizren – 500,000.00 €

Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe vendosja e pusetave dhe ujëmatësve jashtë pronës private në fshatin Zhur – Prizren – 700,000.00 €.

Gypsjellësi Ø 400 mm në zonat e qytetit të Prizrenit – 544,000.00 €.

Rrjeti i ujësjellëst në zonën „Nënkalaja “ – Prizren – 185,000.00 €.

Gypsjellësi □ 400 mm në Rr, „Ibrahim Rugova “ – Prizren (e përfunduar më 07.07.2022) – 150,000.00 €.

Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit në Rr. Xhavit Syla “-Suharekë – 201,000.00 €,

Vendosja e ujëmatësave dhe aftësimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Peqan – Suharekë – 52,300.00 €.

Rehabilitimi i njësisë së koagulimit e filtrimit dhe burimit Radesha në Dragash – 30,000.00 €.

Furnizimi me paisje detektuese dhe paisje për prerjen e asfaltit për nevojat e NJP Dragash – 10,000.00 €.

Vazhdimi i shqyrtimeve dhe analizave profesionale te stacioneve dhe sistemeve elektropompuse, përpilimi i projekt dokumentacioneve investive për elektropompa, material elektrik, pëshjtjellimin dhe servisimin e elektromotorëve, furnizimin me vegla pune dhe makineri e mekanizëm përcjellës dhe furnizime tjera të ngjashme.

Mbështetja në planifikimet dhe hartimet e dokumentacioneve strategjike, sigurisë së burimeve ujore, menaxhimit të krizave, menaxhimit të aseteve, auditimet dhe evaluimet teknike me bashkëpunëtorët e DT te raporteve për institucionet kompetente dhe projekteve te papërfunduara dhe ato në ekzekutim e sipër.

Kontributi profesional në zbatimin dhe avancimin e aplikacioneve softwerike dhe menaxheriale në shërbim të rritjes së efikasitetit të Kompanisë.

Kontributi I drejtëpërdrejtë në cilësinë e anëtarit të Komitetit Teknik të Konferencës së ujit – Nëntor 2022 për përzgjedhjen dhe selektimin e abstrakteve dhe projekteve prezantuese dhe moderimi i sesionit Teknik në temën; trajtimi I ujërave të ndotura.

Vazhdimi i kryerjes së detyrave të punës nga pozicioni paraprak në mungesë të zëvendësimit në cilësinë e menaxherit të projekteve. Menaxhimi i kontratave të filluara nga pozicioni paraprak dhe në vijimësi me OE vendor dhe ndërkombëtar, me Telekom, IPKO, KEDS e operator tjerë, evidentimi dhe procesimi për pagesë i shpenzimeve mujore energjetike e telekomunikuese, përkrahjen dhe ofrimin e zgjidhjeve teknike, hartimin e projekt dokumentacione investive propozuese dhe paramasave e parallogarive në fushën elektroteknike, kujdesi për mbarëvajtjen operative të infrastrukturës fizike të njësive punuese të Kompanisë.

Aktivitet e departamentit teknik të ndërmarra për eliminimin e humbjeve teknike.

Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale.

Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – detektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për detektim.

Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatorëve që ta paguajnë ujin në mënyre që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do tu kthehet konsumatorëve në shërbime dhe investime për shërbim sa me efikas të furnizimit me ujë të pijes.

Prodhimi i ujit m<sup>3</sup> - Tetor - Dhjetor, 2022

Muaji	Prodhimi mujor m <sup>3</sup>	Prodhimi ditor- m <sup>3</sup>	Prodhimi (l/sec)	Komente
Prizren	2,622,600.00	28,506.52	329.9	
Suharekë	649,421.00	7,058.92	81.7	
Dragash	234,812.00	2,552.30	29.5	
Malishevë	363,633.00	3,952.53	45.7	
<b>Total</b>	<b>3,870,466.00</b>	<b>42,070.28</b>	<b>486.9</b>	

Mirëmbajtja e rrjetit – Sanimi i defekteve / Tetor - Dhjetor, 2022

Njësia Operative	Ujësjellësi - uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	519	132	651
Suharekë	106	34	140
Dragash	14	07	21
Malishevë	112	18	130
<b>Total</b>	<b>751</b>	<b>191</b>	<b>942</b>



## Zyra për planifikim dhe zhvillim – Tetor - Dhjetor, 2022

### AKTIVITETET KRYESORE

- \* Përpilimi i raportit TM-4, 2022.
- \* Përpilimi i pëlqimeve, përgjigjeve në kërkesa për konsumatorët.
- \* Plotësimi i platëformës së Benchmarking për vitin 2021.
- \* Plotesimi i të dhënave për Strategjin e Ujërave (Afrim Lajçi).
- \* Punime në Novak shpimi i pusit për Mamushë.
- \* Plani i Bisnesit 2023-2025.
- \* Pjesmarrje dhe prezantime nga inxhinierat e D.Teknik në Konferencën e ujërave në Prishtinë.
- \* Takime, vizit në teren dhe përcjellje të të dhënave, me kompaninë fituese (INSI) për Përpilimin e Fisibilitetit të burimeve të ujit në pjesen jug-perindimore të Prizrenit.
- \* Takim dhe vizit në teren me ARRU-në dhe AMK-në për kontroll të ujëmatësat e prodhimit.
- \* Përcjellja e komenteve nga KRU "HRJ" , takim në zyret e kompanisë HRJ dhe përcjellja e të dhënave për kompaninë INSI (Përpilimi i Fisibilitetit të burimeve të ujit në pjesen jug-perindimore të Prizrenit).
- \* Përpunimi i Planit për menaxhimin e aseteve (Alberti, Besari dhe Genti).
- \* Përgjigje në pytyet e parashtruar nga Bordi i KRU "HRJ" - Prizren.
- \* Plani i veprimit për ujëmatësat e prodhimit – kërkes nga Bordi i KRU "HRJ" - Prizren.
- \* Vendosja e ujëmaësave të prodhimit dhe zonal – aktivitet regjional në kuadër të kompanisë.
- \* Auditim nga Ymredin Sylejmani (auditor i brendëshem i kompanisë).
- \* Përpilimi i projekt propozimeve.
- \* Inicimi i projekteve për realizim.
- \* Menaxhimi i kontratave në sistemin e Prokurimit.
- \* Vlersimi i kontratave në Prokurimit.
- \* Mbikqyrje të projekteve: "Φ400 mm" , rehabilitimi i kaptazhës "Sozi" , Landovicë, 5 rrugët në Prizren, riparimi i objektit të Filtrat dhe zyret administrative - Prizren, Rr. "Xhavit Sylja" , lagja e Bajraktarve (rr. Zek Bajraktari), shpimi i pusit në Dobërdelan dhe punime në fshatin Peqan - Suharekë, Rehabilitimi i kaptazhës "Radeshë" dhe Kuagulatorët në Dragash.
- \* Vizita të rregullta në teren në kuadër të mbikqyrjeve.
- \* Matje gjeodezike dhe aktivitete të ndryshme profesionale për nevoja të kompanisë.
- \* Pasurimi i GIS-it me të dhëna.

\* Aktivitetet e grupeve janë të paraqitura në table.

Aktivitetet/Grupet - e menaxhuar nga Departamenti Teknik		
Grupet	Aktivitetet e grupeve gjatë muajit Tetor-Dhjetor - 2022	
Kalibrim i ujëmatësave (Bazhdarim)	285	riparime të ujëmatësave
	6	ekspertiza
Ndërrimi i ujëmatësave (D-M)	461	vizita të konsumatorët
	250	ndërrime të ujëmatësave
	81	riparim të defekteve gjatë ndërrimit
Detektimit të rrjetit	204	detektive
	146	defekte të gjetura
	5,030	rrjet i detektuar (m)
Bllombimit	572	bllombim dhe kontrata
	1270	dera mbyllur të konsumatorët
	52	kërkesa nga konsumatorët për bllombim
	1	konsumator duhet të ndërrohet ujëmatësi
	2	konsumatorëve duhet zëvendësuar ujëmatësi
	1	konsumator që duhet të ndërrohet regjistrohet

#### Raporti mbi cilësinë e ujit të pijes për muajt Tetor - Dhjetor 2022

- Kontrolli permanent i prezencës së klorit residual në kroje në qytet si dhe kontrollimi i klorit në fshatra.
- Furnizim i stacioneve të klorifikimit me Hipoklorit të Natriumit në të gjitha fshatrat.
- Marrja e mostrave sipas planit të monitorimit.
- Kontrolli permanent i kualitetit të ujit në burime si dhe sasinë e cila shfrytëzohet.
- Kontrolli i rregullt i stacioneve të klorifikimit mbi mbarvajtjen e procesit dhe paisjeve.
- Në stacionin e klorinimit në Zhur ishim për ta ndërruar aparatin e klorinimit.
- Në stacionin e klorinimit në "Bunar 1" riparuam vakumrregullatorin i cili nuk funksiononte si duhet.
- Në suaza ditore të rregullta vëzhguam cilësinë e ujit nga Pusi i ri në Novak.
- Në stacionin e klorinimit ndërruam ventilin i cili mundëson ndaljen dhe injektimin e klorit në gyp përmes pompës.
- Në stacionin e klorinimit në "40 Burime" ndërruam ventilat dy copë të cilat mundësojnë ndaljen e injektimit të klorit në gyp përmes pompës.
- Gjithashtu ndërruam edhe dy vakumrregullator dhe dy rotometra në sistemin e klorinimit në stacionin "40 Burime" .

- Në stacionin e klorinimit në "40 Burime" riparuar disa pjesë fazonike në sistemin e klorinimit.

Gjithashtu ndërruam edhe dy vakumrregullator dhe dy rotometra në sistemin e klorinimit në stacionin "Galeria I" .

Analizat Bakteriologjike, Tetor - Dhjetor / 2022, Lab. i kompanisë

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave		Nr. i mostrave që nuk përgjigjen	
		Bakteriologjike	Kimike	Bakteriologjike	Kimike
Prizren	Burim	19	19	17	1
	Ujësjetllës	36	36	0	0
Suharekë	Burim	9	9	5	0
	Ujësjetllës	14	14	0	0
Dragash	Burim	6	6	5	0
	Ujësjetllës	8	8	0	0
Malishevë	Burim	7	7	5	0
	Ujësjetllës	9	9	0	0
<b>Totali</b>			<b>216</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Analizat Bakteriologjike, ISHP-Prizren, Tetor - Dhjetor / 2022

Njësia	Lloji i ujit	Nr. i mostrave bakteriologjike	Nr. i mostrave që nuk përgjigjen
Prizren	Burim	4	0
	Ujësjetllës	416	0
Suharekë	Burim	4	0
	Ujësjetllës	64	0
Dragash	Burim	0	0
	Ujësjetllës	24	0
Malishevë	Burim	4	0
	Ujësjetllës	56	1
<b>Totali</b>		<b>572</b>	<b>1</b>

Vrejtje: Numri i analizave të mostrave bakteriologjike të marrura në rrjetin e ujësjetllësit është 560 mostra, ku 1 prej të cilave nuk i përgjigjen standarteve të ISHP.

### 1.1.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Keqpërdorimi i ujit të pijes.
- Ndërprerja e kohe pas kohëshme të energjisë elektrike.

- Shpenzimet e mëdha të energjisë elektrike.

#### 1.1.4 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Të gjitha defektet në sistem të ujësjellësit dhe kanalizimit janë sanuar me kohe,
- Është përcjell në mënyrë permanente cilësia e ujit të pijes në nivel regjional,
- Është përgatitur dhe miratuar strategjia e UPF-së.

#### 1.1.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM

- Monitorimi i furnizimit me ujë të pijes në gjithë zonën e shërbimit,
- Monitorimi i cilësisë së ujit të pijes në nivel regjional,
- Vazhdimi i analizës së rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit si dhe bartja e të dhënave në GIS,
- Implementimi i strategjisë për uljen e UPF-se.

\*Aktivitet e shërbimit teknik të ndërmarra për eliminimin e humbjeve teknike.

- Identifikimin dhe mënjanimin e lidhjeve ilegale.
- Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – detektimi i rrjetit të ujësjellësit dhe ndarja e zanave për detektim.
- Ngritjen e vetëdijes të të gjithë konsumatorëve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatorëve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.


## II. RAPORT I DEPARTAMENTIT PËR KONSUMATORË

### 2.1 RAPORT I PERFORMANCËS

TM3- TM4 -2022

#### 2.1.1 NUMRI I KONSUMATORËVE


NUMRI I FATURAVE TË LËSHUARA					
No.	Të dhënat	TM1- 2022	TM2-2022	TM3-2022	TM4-2022
1	Shtëpiak	48,122	48,868	49,328	49,855
2	Ndryshimi		746	460	527
3	Ndryshi. %		1.55%	0.94%	1.07%
4	Kome.-Indu.	6,179	6,214	6,256	6,324
5	Ndryshimi		35	42	68
6	Ndryshi. %		0.57%	0.68%	1.09%
7	Institucional	342	344	345	346
8	Ndryshimi		2	1	1
9	Ndryshi. %		0.58%	0.29%	0.29%
<b>10</b>	<b>TOTAL</b>	<b>54,643</b>	<b>55,426</b>	<b>55,929</b>	<b>56,525</b>
<b>11</b>	<b>Ndryshimi</b>		<b>783</b>	<b>503</b>	<b>596</b>
<b>12</b>	<b>Ndryshi. %</b>		<b>1.43%</b>	<b>0.91%</b>	<b>1.07%</b>



## 2.1.2 FATURIMI - m3

## TM1-TM2-TM3-TM4- 2022

FATURIMI - m3					
No.	Të dhënat	TM1- 2022	TM2- 2022	TM3- 2022	TM4- 2022
1	Shtëpiak	1,428,376	1,716,705	2,014,733	1,512,606
2	Ndryshimi		288,329	298,028	(502,127)
3	Ndry. %		20.2	17.4	(24.9)
4	Kome.-Indu.	142,383	162,827	207,030	166,087
5	Ndryshimi		20,444	44,203	(40,943)
6	Ndry. %		14.4	27.1	(19.8)
7	Institucional	100,099	118,865	114,717	119,734
8	Ndryshimi		18,766	(4,148)	5,017
9	Ndry. %		18.7	(3.5)	4.4
10	<b>TOTAL</b>	<b>1,670,858</b>	<b>1,998,397</b>	<b>2,336,480</b>	<b>1,798,427</b>
11	Ndryshimi		327,539	338,083	(538,053)
12	Ndry. %		19.6%	16.9%	-23.03%




## 2.1.3 FATURIMI - €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A – PRIZREN

TM1-TM2-TM3-TM4- 2022

FATURIMI - €					
No.	Të dhënat	TM1- 2022	TM2- 2022	TM3- 2022	TM4- 2022
1	<b>Faturimi-€</b>	<b>1,145,917.64</b>	<b>1,329,503.81</b>	<b>1,520,804.41</b>	<b>1,234,894.21</b>
2	Total- Shte.	883,999.34	1,032,683.30	1,188,091.26	932,154.64
3	Ndryshimi	(18,806.80)	148,683.96	304,091.92	(255,936.62)
4	Ndry. %	(0.06)	16.8%	34.4%	-21.5%
5	Total- kome.	170,354.35	188,432.82	227,495.42	193,143.11
6	Ndryshimi		18,078.47	57,141.07	(34,352.31)
7	Ndry. %		10.6%	33.5%	-15.1%
8	Total-Inst.	91,563.95	108,387.69	105,217.73	109,596.46
9	Ndryshimi		16,823.74	13,653.78	4,378.73
10	Ndry. %		18.4%	14.9%	4.2%
11	Te tjera	21,464.94	14,252.58	16,819.32	19,296.89
12	<b>Total</b>	<b>1,167,382.58</b>	<b>1,343,756.39</b>	<b>1,537,623.73</b>	<b>1,254,191.10</b>
13	Ndryshimi		176,373.81	370,241.15	(283,432.63)
14	Ndry. %		15.1%	31.7%	-18.4%




## 2.1.4 ARKËTIMI -€

TM1-TM2-TM3-TM4 - 2022

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN

No.	Të dhënat	TM1- 2022	TM2- 2022	TM3- 2022	TM4- 2022
1	Total- Shtëpiak	852,720.47	858,400.13	1,162,687.63	972,798.49
2	Ndryshimi		5,679.66	304,287.50	(189,889.14)
3	Ndry. %		0.7%	35.4%	-16.3%
4	Total-Komercial-Industrial	209,970.45	183,732.27	222,671.93	203,149.14
5	Ndryshimi		(26,238.18)	38,939.66	(19,522.79)
6	Ndry. %		-12.5%	21.2%	-8.8%
7	Total Institucional	64,787.51	114,001.79	136,494.69	130,206.34
8	Ndryshimi		49,214.28	22,492.90	(6,288.35)
9	Ndry. %		76.0%	19.7%	-4.6%
10	Total - ujë	1,127,478.43	1,156,134.19	1,521,854.25	1,306,153.97
11	Ndryshimi		28,655.76	365,720.06	(215,700.28)
12	Ndry. %		2.5%	31.6%	-14.2%
13	Te tjera	18,944.41	17,568.42	17,209.54	16,228.72
14	Ndryshimi		(1,375.99)	(358.88)	(980.82)
15	Ndry. %		-7.3%	-2.0%	-5.7%
16	TOTAL	1,146,422.84	1,173,702.61	1,539,063.79	1,322,382.69
17	Ndryshimi		27,279.77	365,361.18	(216,681.10)
18	Ndry. %		2.38%	31.13%	-14.08%





## 2.2 KOMENTET NGA DEPARTAMENTI PËR KONSUMATOR

### 2.2.1 AKTIVITETET KRYESORE

- Kemi një faturim më të vogël se në krahasim me TM paraprak, si rezultat i rënies së konsumit se zonal.
- Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellësit brenda afatit ligjor te secili konsumatorë.
- Janë vizituar nga lexuesit të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar arkëtimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellësit.
- Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike ndërsa ankesat komerciale të konsumatorëve janë shqyrtuar sipas prioritetit të tyre.

### 2.2.2 RAPORT I ANKESAVE TEKNIKE DHE KOMERCIALE

- Janë shqyrtua ankesat teknike dhe komerciale në nivel rajonal:

Ankesat Teknike për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	703
Ankesat Teknike të Shqyrtuara me Kohë	numër	703
Ankesat Komerciale për Shërbimet e Ujit dhe Kanalizimit	numër	203
Ankesat Komerciale të Shqyrtuara në Kohë	numër	203
Ankesat Komerciale të Zgjidhura me Kohë	numër	203

### 2.2.3 RAPORT I INSPEKTIMIT

- Kanë vazhduar kontrollat në teren te konsumatorët nga ekipi i inspektimit dhe verifikimet tek konsumatorët dhe aktivitetet janë të prezantuara ne tabelën e mëposhtme:

## RAPORT I EKIPES SË INSPEKTIMIT

*KRU "Hidroregjioni Jugor" sha*

**PERIUDHA**

**RAPORTUESE :**

**TM4 2022**

Njesite operative	Shperndarja e njoftimeve paralajmeruese per permbarim	Konsumatorët e legalizuar	Lidhjet e paligjshme të zbuluara	Nr. i shkycjeve	Verifikimi i leximit të ujëmatësve	Nr. i leximeve të gabuara	Rastet e dorezuara per gjykatë	Vizita nga ankesat/kesat konsumatore	Shuma e inkasuar nga borxhet e vjetra
Prizren	5,202	413	6	15	3,730	19	1	194	116,474
Suharekë	1,177	39	3	3	960	26	0	54	19,765
Malishevë	120	31	0	15	126	26	0	9	0
Dragash	0	6	2	2	22	0	0	2	170
<b>TOTAL</b>	<b>6,499</b>	<b>489</b>	<b>11</b>	<b>35</b>	<b>4,838</b>	<b>71</b>	<b>1</b>	<b>259</b>	<b>136,408.76</b>

### 2.2.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

- Mos kontimi i disa ujëmatësve si rezultat i amortizimit të tyre apo arsyeve teknike tjera
- Mos pagesa e obligimeve nga institucionet dhe një pjesë të borxheve të kontraktuara nga një pjesë e madhe e konsumatorëve të cilët kanë nënshkrua kontratë për pagesën e borxheve me këste, si rezultat i pamundësisë dhe rënies së fuqisë financiare .
- Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpuara që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjencionit Kosovar të Pronës, bizneset që kanë falimentuar.

### 2.2.5 MASAT E REALIZUARA/MOSREALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE

- Kemi një rritje të numrit të konsumatorëve si rezultat i pëlqimeve për kyçje dhe legalizimeve.
- Aktivitete me përmbaues privat (dalja në teren me ekipet e kontrolles, identifikimi i adresave, identifikim i konsumatorëve, trashëgimtarëve të tyre etj.), janë ndërprerë gjatë kësaj periudhe.
- Janë shpërnda njoftime para inicimit të procedurës përmbaimore në terrenet e inkasantëve në qytet.

- Janë vizituar konsumatorët të cilët kanë ngec në pagesën e kësteve, nga kontratat për pagesën e borxhit me këste, mirëpo te kjo kategori janë dërguar mesazhe përmes telefonit ku është kërkuar pagesa kësteve të papaguara dhe obligimeve rrjedhëse.

### **2.2.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM**

- Vazhdimi i dërgimit të rasteve në përmbarim
- Vazhdimësi e thirrjeve me telefon dhe dërgimi i mesazheve përmes telefonit te konsumatorët të cilët nuk i përmbahen kontratës.
- Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në teren, shpërndarja e paralajmërimeve para inicimit të rasteve te përmbaruesi duke i ndërruar terrenet e inkasantëve.
- Vizita më të shpeshta te konsumatorët e bizneseve të cilët kanë borxhe, ata të cilët kanë bërë kontratë e të cilët nuk i përmbahen pagesës së kësteve.
- Vazhdimësia e mbështetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrolles te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajnë faturat.
- Mbikëqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkasantëve në arritjen e limiteve në arkëtim
- Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyçen në shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit.

### III. RAPORT I DEPARTAMENTIT PËR FINANCA

#### 3.1 AKTIVITETE KRYESORE

Ky raport përfshinë disa aktivitete nga shërbimi financiar në pika të shkurtra, aktivitete të cilat janë komfor rregullores së punës së kompanisë si dhe ligjeve në fuqi. Duke u nisur nga regjistrimet e rregullta dhe të drejta sipas ligjeve në Kosovë e deri te aktivitetet tjera për një përformacë sa më të mirë të kompanisë, dhe disa nga to janë:


- Përgatitja e raporteve tremujore për TM3 2022;
- Kontrollimi dhe barazimi i të pagueshmeve dhe atyre të arkëtueshmeve,
- Përgatitja e raporteve mujore financiare, si arkëtimin, të hyrat dhe ato të shpenzimeve, gjithashtu edhe raportet tremujore;
- Hapja dhe përgatitja e pagave për muajt përkatës, kontrollim, barazim dhe verifikim të regjistrit të të punësuarve;
- Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me arkëtimet ditore, ato të amvisërisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, kontimin e tyre, barazimet etj.;
- Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, si dhe aprovimi i tyre për blerje;
- Kontrollimi dhe pranimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;
- Pagesa e furnitorëve, pas kontrollimit të blerjeve; barazimi i të pagueshmeve;
- Plotësimin e librave të blerjes dhe shitjes sipas ligjeve dhe formës standarde të kërkuar nga ATK, për muajt përkatës, mujor e tremujor;
- Deklarimet e tatimeve, TVSH-së, tatimet e pagave etj., sipas ligjeve në fuqi;
- Raportimet tremujore ndaj ARRU-së
- Raportimet tremujore ndaj njësisë për ndërmarrjet publike;
- Raportimet tremujore ndaj Agjensisë së Statistikave të Kosovës;

## 3.2 ARSYESHMËRIA E SHPENZIMEVE

SHPENZIMET - €

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A – PRIZREN  
TM3-TM4 2022

SHPENZIMET - €					
No.	Të dhënat	TM1- 2022	TM2- 2022	TM3- 2022	TM4- 2022
1	Total Shpenzimet Operative	<b>977,527.96</b>	<b>983,194.72</b>	<b>1,038,591.99</b>	<b>1,129,251.61</b>
2	Pagat	595,580.52	596,686	623,674	670,945
3	Rryma elektrike	247,718.67	230,183	225,051	231,739
4	Shpen. e derivateve	30,607.23	28,503	35,852	40,320
5	Mirem. dhe riparimet	35,506.28	34,245	36,785	61,321
6	Mirem. e automjeteve	10,031.68	11,501	14,221	26,163
7	Shpen.e taksave	27,017.02	19,614	29,586	20,179
8	Kemikaliet	1,269.66	8,626	12,869	13,138
9	Shpenzimet e tjera	29,796.90	53,837	60,552	65,447
2	Ndryshimi		5,666.76	55,397.27	90,659.62
3	Ndryshimi ne %		0.58%	5.63%	8.73%



Shpenzimet operative të ndërmarrjes për tre mujorin e IV-të 2022, në krahasim me shpenzimet e tremujorit të III-të 2022, janë më të larta;

Më poshtë do t'i cekim disa nga pozicionet, të cilat kanë lëvizur më së shumti dhe arsyet e rritjes apo uljes së tyre;

- Në pozicionin e pagave kemi rritje të shpenzimeve në krahasim me tremujorin e kaluar; për shkak se në muajin dhjetor, për të gjithë punëtorët është dhënë shpërblim prej 100 euro për festat e fundvitit. Pra kjo është një nga arsyet për rritje të shpenzimeve të kësaj kategorie;
- Ndërsa tek pozicioni i energjisë elektrike nuk kemi ndonjë lëvizje të madhe të shpenzimeve, përveç në njësinë e Prizrenit një rritje, që mund të jetë nga shpenzimi i energjisë për ngrohje, por këto shpenzime varen edhe nga angazhimi i pompave që janë në funksion për nxjerrje të ujit sipas nevojës dhe konsumit;
- Edhe te pozicioni i derivateve kemi një rritje të shpenzimeve, për shkak të angazhimit më të madh të makinerisë në kryerjen e aktiviteteve. Po ashtu, pasi që jemi në sezonin e dimrit, derivatet përdoren edhe për ngrohje qendrore;
- Rritje më të madhe kemi te pozicioni i mirëmbajtjes dhe riparimeve, dhe mirëmbajtjen e pompave, për shkak se në këtë tremujor ka pasur më shumë intervenime në mirëmbajtje se sa tremujori i kaluar;
- Rritje kemi pasur edhe te pozicioni i mirëmbajtjes së automjeteve; në veçanti kemi rritje në Njësinë e Prizrenit dhe te Malishevës, pasi që në këtë tremujor, ka pasur nevojë më shumë për riparime të makinerisë si dhe regjistrimet vjetore të tyre;
- Ndërsa rënie kemi te shpenzimet e taksave, për shkak se në këtë tremujor, kemi më pak lëndë të dërguara tek përmbaruesi, ndërsa shpenzimet e anëtarësisë në SHUKOS edhe ato të ARRU-së mbetën të njëjta;
- Te shpenzimet tjera, ku përfshihen shpenzimet e administratës, shpenzimet e telefonisë, shpenzimet e udhëtimeve zyrtare, shpenzimet e interesit, shpenzimet e trajnimit të stafit të kompanisë, shpenzimet e provizioneve etj., nuk kemi ndonjë rritje të madhe të kësaj kategorie;

Pra si përfundim, shpenzimet totale, për këtë tremujor kanë qenë më të larta në krahasim me tremujorin e kaluar, për arsyet e cekura me lartë. Pra, pozicioni i pagave, i derivateve si dhe mirëmbajtjes, kanë qenë pozicionet që kanë ndikuar më shumë në rritjen totale të shpenzimeve operative;

### 3.3 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE

Duke e parë gjendjen financiare në KRU Hidroregjioni Jugor Sh.A. Prizren, Kompania gjendet para katër problemeve relativisht të mëdha, respektivisht rreziqeve relativisht të mëdha:

Eliminimi I të gjeturave nga ZKA për vitin 2021 , sidomos e Gjetura nr.1 – Detyrimet Tatimore ndaj ATK (TVSH) e për të cilin obligim ATK nuk pretendojnë, pasi që borxhi është I vjetërsuar , si dhe e gjetura nr. 8- Që ka të bëjë me llogarit e arkëtueshme të cilat janë relativisht të larta , e që donë një trajtim të veçantë për tu vendos në kategorinë e “ Borxheve të Këqija ” Të dyja këto të gjetura janë të ndërlidhura mes veti.

Vendimi i Gjykatës Themelore mbi borxhin e Kompanisë ndaj KEK , për të cilin borxh, ne kemi arrit marrëveshje me KEK-un për përmbushjen e obligimit për 12 vite . obligimi mujor është 10,064.00 ,ndërsa obligimi vjetorë është 120,768.00 euro

Pamundësia e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme të vjetërsuara , ekziston rreziku i parashkrimit te borxhit, pasi që janë më të vjetra se një vit. Ky problem na përcjell çdo vitë .

Detyrimet kontigjente -kërkesat e punëtoreve ndaj kompanisë që kanë vendim gjykate shuma 94,000.00 euro. Ekzistojnë edhe detyrime tjera kontigjente por që ende nuk kanë epilogë gjykate.

### **3.4 MASAT E REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE**

- Kompania ka arritë që ti përmbush obligimet ndaj KEK-ut sipas marrëveshjes .Shuma e këstit është 10,064.00 Euro.

### **3.5 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM**

Të bëhen përpjekje të vazhdueshme që të kërkohet ndihmë edhe nga ana e Qeveris së Kosovës perkatësisht MZHE. për ndihmë financiare ne mënyrë që te përballohen këto probleme. Sidomos borgji ndaj KEK-ut


Te bëhen përpjekje për inkasimin e llogarive të arkëtueshme para se ato të mundë të parashkruhen.

Të trajtohen llogarit e arkëtueshme me qëllim të eliminimit të të gjetures së Auditorit të ZKA-së.

**TREGUESIT KRYESOR TË PERFORMANCËS**  
**K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN**

**TM1-TM2-TM3-TM4- 2022**

<b>Treguesit e Performancës</b>		<b>TM1-2022</b>	<b>TM2-2022</b>	<b>TM3- 2022</b>	<b>TM4- 2022</b>
Uje i faturuar-si perqindje	%	45.9%	46.2%	46.6%	46.5%
Uje i pafaturuar-si perqindje	%	54.1%	53.8%	53.4%	53.5%
Norma e arketimit - e pergjithshme	%	<b>98.4%</b>	<b>87.0%</b>	<b>100.1%</b>	105.8%
Norma e arketimit - Amviserite	%	<b>96.5%</b>	<b>83.1%</b>	<b>97.9%</b>	104.4%
Norma e arketimit -Komercial-Industrial	%	<b>123.3%</b>	<b>97.5%</b>	<b>97.9%</b>	105.2%
Norma e arketimit -Institucional	%	<b>70.8%</b>	<b>105.2%</b>	<b>129.7%</b>	118.8%
Norma e Mbulimit operativ	numer	1.17	1.19	1.48	1.17
Staf per 1000 konsumatore	numer	<b>5.96</b>	<b>5.87</b>	<b>5.78</b>	<b>5.74</b>





**RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE**  
**TM3- TM4-2022**

• **HIDROREGJIONI JUGOR**

MUAJI	TM3-2022	TM4-2022	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<i>Prodhimi m3</i>	5,018,661	3,870,466	(1,148,195)	-22.9%
<i>Faturimi m3</i>	2,336,480	1,798,427	(538,053)	-23.0%
<i>Faturimi nga uji €</i>	1,520,804.41 €	1,234,894.21 €	(285,910)	-18.8%
<i>Faturimi- te tjera €</i>	16,819.32 €	19,296.89 €	2,478	14.7%
<i>Faturimi Total €</i>	<b>1,537,623.73 €</b>	<b>1,254,191.10 €</b>	(283,433)	-18.4%
<i>Inkasimi nga uji €</i>	1,521,854.24 €	1,306,153.95 €	(215,700)	-14.2%
<i>Inkasimi - te tjera €</i>	17,209.54 €	16,228.72 €	(981)	-5.7%
<i>Inkasimi Total €</i>	<b>1,539,063.78 €</b>	<b>1,322,382.67 €</b>	(216,681)	-14.1%
<i>Nr. i Konsumatorëve</i>	55,929	56,525	596	1.1%
<i>% e inkasimit</i>	100.07	105.77	5.7	
<i>Shpenzimet</i>	<b>1,038,591.99 €</b>	<b>1,129,251.61 €</b>	90,659.62 €	8.7%
<i>Pagat</i>	623,673.96 €	670,944.50 €	47,270.54 €	7.6%
<i>Rryma elektrike</i>	225,051.32 €	231,738.94 €	6,687.62 €	3.0%
<i>Shpe. e derivateveve</i>	35,852.07 €	40,320.14 €	4,468.07 €	12.5%
<i>Miremb. Dhe riparimet</i>	36,785.38 €	61,321.28 €	24,535.90 €	66.7%
<i>Miremb. e automjeteve</i>	14,221.19 €	26,163.34 €	11,942.15 €	84.0%
<i>Shpen. E taksave</i>	29,586.27 €	20,179.29 €	- 9,406.98 €	-31.8%
<i>Kemikalet</i>	12,869.42 €	13,137.52 €	268.10 €	2.1%
<i>Shpenzimet tjera</i>	60,552.38 €	65,446.60 €	4,894.22 €	8.1%
<i>Uji I pafaturuar në m3</i>	2,682,181	2,072,039	(610,142)	-22.7%
<i>Uji I pafaturuar ne %</i>	53.44	53.53	0.1	
<i>Mbulimi operativ</i>	1.48	1.17	(0.31)	

500,471.79 €

193,131.06 €

## 3.6 TRANSAKSIONET KRYESORE- TM4-2022

10 pagesat me te medha nga Hidroregjioni Jugor per Operatoret TM4 2022

Data	Nr i dokumentit	Nr. I fat.	Emri I operatorit	Shuma
12/19/2022	BPBPZNPOS-004599	FUR-01661	Pag.fat.40/2022 K-ING sh.p.k.	98,485.89
12/7/2022	BPBPZNPOS-004537	FUR-01712	Pag.fat.22-300-000391 INTERADRIA L.L.C	36,935.00
11/25/2022	BPBPZNPOS-004412	FUR-01788	Pag.fat.011/2022 PRO Constructions SH.P.K.	31,689.08
12/23/2022	NLB-P-00027754	FUR-01039	KEK - Bunari I	24,037.99
11/25/2022	NLB-P-00027515	FUR-01039	KEK - Bunari I	24,033.15
10/25/2022	BPBPZNPOS-004217	FUR-01039	KEK - Bunari I	22,635.51
12/30/2022	BPBPZNPOS-004731	FUR-01788	Pag.fat.014/2022 PRO Constructions SH.P.K.	22,589.06
12/30/2022	NLB-P-00027824	FUR-01756	CO-ING Afrim S. Ibrahimimi fat.14/2022	21,246.48
12/30/2022	NLB-P-00027829	FUR-01750	BG-ING Bajram Ha. Gashi B.I. fat.020/2022	19,591.42
10/4/2022	TEB-SH-000001961	FUR-01016	NPT Xerxa fat.101/09	19,484.27
<b>TOTAL</b>				<b>320,727.85</b>

10 pagesat me te medha ndaj Hidroregjioni Jugor per TM4 2022

Data	Kons	Emri I konsumatorit	Banka	Kategoria	Shuma
14.12.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	11,640.36
14.12.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	10,957.92
11.10.2022	KONS-0029796	Qendra Medicinale SPITALI	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	10,386.54
13.12.2022	KONS-0029809	Sh.K.K Qendra e paraburgimit - Prizren	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	4,000.00
09.12.2022	KONS-0029749	K.R.U "Gjakova" Sh.A - Nj. Prizren	Banka per Bisnes	BIZNESE	3,060.92
27.10.2022	KONS-0037156	Sh.Mesme "Jeta e Re"	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	2,461.88
23.11.2022	KONS-0029814	K.KOMUNAL.DREJT. PER AMB.DHE SHERB.PUBLIK	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	2,280.44
07.11.2022	KONS-0029851	Sh.f.m.u "Lekë Dukagjini"	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	1,999.78
01.12.2022	KONS-0059600	Galeria Shopping Mall SH P K	Teb Banka	LOKALET	1,958.55
25.11.2022	KONS-0029881	Sh.f.m.u "Fadil Hisari"	Banka per Bisnes	INSTITUCIO	1,861.60
<b>TOTAL</b>					<b>50,607.99</b>

## VI. RAPORT I DEPARTAMENTIT TE UN-ITUN

### 4.1 FUSHËVEPRIMI I DEPARTAMENTIT TË -ITUN

Departamenti i UN-ITUN ne fushe veprimtarinë e tijë përfshinë:

- Grumbullimin e ujerave te ndotura për qytetin e Prizrenit, Malishevës Suharekës dhe Dragashit përmes sistemeve ekzistuese dhe sistemeve te reja ne ndërtim e sipër,
- Mirëmbajtjen e ujerave te ndotura për qytetin e Prizrenit, Malishevës Suharekës dhe Dragashit përmes sistemeve ekzistuese dhe sistemeve te reja ne ndërtim e sipër,
- Konsolidimin e sistemeve ekzistuese dhe Planifikimin e sistemeve te reja te kanalizimeve ne nivel regjional,
- Trajtimin e ujerave te ndotura përmes Impianteve për trajtimin e ujerave te ndotura te cilat janë ndërtuar, janë ne ndërtim e sipër dhe do te ndërtohen ne te ardhmen.
- Konsolidimin e impianteve ekzistuese dhe planifikimin e impianteve te reja centrale dhe parciale ne nivel regjional,
- Monitorimin dhe konsolidimin e ujerave industriale ne nivel regjional,
- Garantimin e parametrave te efluantit sipas direktivave dhe udhëzimeve ne fuçi te cilat përcaktojnë shkallen e ndotjes e cila lejohet te shkarkohet ne trupat pritëse.

Aktualisht jemi duke operuar me ITUN për qytetin e Prizrenit dhe jemi ne procedure te menaxhimit edhe me Impiantin e Bukoshit-Suhareke dhe Impiantin e Kukit-Dragash.

#### *SATATUSI I PROJEKTIT FAZA-1-*

Ndërtimi i kolektorit kryesor dhe interceptoreve ne rruge, ana e djathte e rrjedhjes se lumbardhit

Ky projekt ka përfunduar ne vitin 2017, qe nga viti 2017 është ne funksion kolektori dhe 7 intereceptoret te cilët shërbejnë për rregullimin hidraulik te kolektorit.

Me këtë rast ju njoftojmë se kemi pasur një defekt ne pompën shtytëse te cilën e kemi dërguar ne muajin shtator tek furnizuesi TIMAK për riparim, sipas informatave fillestare pompa do te sanohet ne fund te muajit Tetot.

Raporti përfundimtar i kompletimit të projektit për fazën 1 është kompletuar dhe do të dërgohet si draft në departamentin e financave, kurse si raport i kompletuar i cili nënkupton përfundimin e kompletuar të fazës 1 do të dërgohet bashkë me raportin përfundimtar për fazën 1 dhe 2, pasi që të miratohet nga KfW-ja, që nënkupton se kjo fazë e projektit mund të regjistrohet përfundimisht si aset i kompanisë.

#### *SATATUSI I PROJEKTIT TE ITUN-se FAZA-2-*

Meqenëse Periudha e Njoftimit të Defekteve (PNJD-DNP) për linjën e llumit ka përfunduar me 06.10.2022, ju njoftojmë se vazhdojmë të jemi në fazën e pranimit-dorëzimit të projektit të impiantit në Prizren, pasi që disa punë të pa përfunduara janë në proces të përfundimit, prandaj fillimisht po ju raportojmë për statusin e projektit të ITUN-se.

Projekti i ITUN-se për qytetin e Prizrenit është leshur në operim në Dhjetor të vitit 2019 dhe atë gjatë fazës së testimeve të cilat kanë qenë pjesë e kontratës dhe si të tilla kanë qenë aktivitete të realizuara nga kontraktori.

Kjo periudhë e testimeve është ndare në dy linja, në linjën e ujit të ndotur dhe linjën e llumit.

Testet për linjën e ujit kanë filluar në dhjetor 2019 dhe kanë përfunduar me 24.06.2021, me ç'rast dhe është lëshuar certifikata e përkohshme marrjes përsipër nga Punëdhënësi dhe konsulenca, respektivisht nga Hidroregjioni dhe P2m Berlin&IDOM&Alb Architect.

Përgjatë kësaj periudhe deri me 24.06.2021, të gjitha shpenzimet operuese dhe të mirëmbajtjes kanë qenë obligim i kontraktorit, pas kësaj date shpenzimet e operimit kanë kaluar tek punëdhënësi, konkretisht të Hidroregjioni Jugor. Periudha e DNP-se (Periudha e njoftimit të defekteve) për linjën e ujit ka filluar me 24.06.2021 dhe ka përfunduar me 24.06.2022, përmes këtij raporti ju njoftoj se DNP (periudha e njoftimit të defekteve) për linjën e ujit të ndotur ka përfunduar me datë 24.06.2022, gjithmonë duke llogaritur se nuk ka lindi ndonjë nevojë për zgjatje të kësaj periudhe të DNP-se edhe pse kontraktori AQUALIA deri më tani ka sanuar disa defekte të njoftuara përgjatë kësaj periudhe dhe është në procedurë të përfundimit të punëve të mbetura të cilat duhet të realizoj-ti përfundoj maksimum deri me 04.10.2022 atëherë kur përfundon periudha e defekteve edhe për linjën e llumit.

Nëse i referohemi raportit TM3 në lidhje me punët e papërfunduara, ju njoftoj se janë riparuar dhe janë testuar përfundimisht tre shtretërve të llumit, dhe furnizimi me material për objektin nr.57, do të furnizohet si i parafabrikuar dhe i gatshëm për instalim.

Testet e linjës së llumit kanë filluar në Qershor-2021 dhe kanë përfunduar pjesërisht me datë 04.10.2021 me crast dhe është lëshuar certifikata e përkohshme e marrjes përsipër me vërejtjet dhe komentet përkatëse nga Punëdhënësi dhe konsulenca, respektivisht nga Hidroregjioni dhe P2m Berlin&IDOM&Alb Architect. Testet kanë përfunduar pjesërisht për shkak të mungesës së llumit sepse në këtë periudhë kohore uji i ndotur në hyrje ka qenë në mesataren e ndotjes bazuar në parametrat

e dizajnit, kontraktori dhe konsulenca detyrohen qe këto teste ti përfundojnë brenda periudhës se DNP-se, behet fjale për testet e garancionit.

Përgjatë kësaj periudhe deri me 04.10.2021, te gjitha shpenzimet operuese dhe te mirëmbajtjes kanë qene obligim i kontraktorit, pas kësej date shpenzimet e operimit kanë kaluar tek punëdhënësi, konkretisht te Hidroregjioni Jugor. Periudha e DNP-se për linjën e Llumit ka filluar me 04.10.2021 dhe do te përfundoj me 04.10.2022, gjithmonë duke llogaritur se nuk do te linde ndonjë nevoje për zgjatje te kësaj periudhe te DNP-se.

Defektet te cilat janë paraqitur gjate kësaj periudhe nga ana jone dhe e konsulences dhe te cilat janë dhe do te duheshin te kryheshin nga ana e kontraktorit do te përshkruajmë si me poshtë për te dy linjat.

Për sa i përket testeve te mbetura te garancionit për linjën e Llumit, ende jemi duke diskutuar me te dy konsulencat e projektit për përcaktimin e metodologjisë nga kontraktori se si munde te realizohen përfundimisht testet e garancionit për linjën e Llumit.

Pas përfundimit te DNP-se (Periudhës se njoftimit te defekteve) për te dy linjat do te lëshohet raporti i kompletimit te projektit, ku do te nënkuptohet si pranim i përgjithshëm teknik.

Konsulenca e projektit sipas kontratës është e detyruar te përgatisë dhe ta dorëzoj raportin e kompletimit për fazën 1 dhe 2, dhe te njëjtin ta dërgojë tek punëdhënësi dhe tek KfW-ja për miratim. Konsulenca e projektit ka dorëzuar raportin e kompletimit për fazën 1 me date 02.11.2021, me plotësimet dhe komentet përkatëse te kërkuara nga KfW, mirëpo për shkak te përfundimit te furnizimit te kamionit thithës shtytës ende nuk është kompletuar raporti përfundimtar për fazën 1, i cili ashtu siç është cekur me larte do te finalizohet ne fund te vitit 2022.

Me 8 GUSHT 2022, konsulenca e projektit ka dorëzuar raportin e kompletimit te projektit për fazën 2 për rishikim tek ne dhe tek KfW-ja, ky raport e mbulon periudhën prej fillimit te projektit për fazën 2 e deri tek marrja përsipër e ITUN-se, kurse periudha e njoftimit te defekteve për fazën 2 sipas konsulences do te mbulohet ne raportin përfundimtar.

Listat për punët e mbetura (Bugs List) është duke u përditësuar dhe si te përditësuar do te raportohet ne periudhën TM4. Kjo liste do te verifikohet përfundimisht ne raportin përfundimtar te kompletimit te projektit.

Kontraktori me date 29.12.2021, lëshon një deklaratë për kompletimin e projektit me te cilën pretendon për pagese shtese duke ju referuar klejmit nr.15 dhe klejmit nr.16, ne si Departament menjëherë kemi reaguar ndaj kësaj deklarate dhe kemi kërkuar sqarim nga konsulenca e projektit e cila menjëherë e ka njoftuar KfW-ne dhe kontraktorin ku dhe përmes letrës zyrtare e ka njoftuar kontraktorin se nuk ka te drejte për një pretendim te tille.

Ne si departament rezervojmë faktin se kontraktori AQUALIA nuk do ta kërkojë këtë kompensim, prandaj edhe përmes raportit TM1 dhe TM2, TM3 po ashtu edhe përmes këtij raporti TM4, ju njoftojmë

se kjo çështje do të duhej të merret seriozisht nga menaxhmenti i kompanisë dhe të diskutohet edhe njëherë përmes një takimi të veçantë edhe me Konsulencën edhe me KfW-ne.

Aktualisht jemi në përmblyllje të projektit për fazën 2, ashtu siç është cekur më lart të gjitha punimet të parapara në kontratë do të pasqyrohen dhe vërtetohen në raportin përfundimtar të kompletimit të projektit të cilin do ta përpiloj konsonanca e projektit dhe do të miratohet nga KfW-ja.

Pasi që të lëshohet raporti përfundimtar i kompletimit, kontraktori e gëzon të drejtën që të kërkojë certifikatën e performancës, në momentin e lëshimit të kësaj certifikate do nënkupton se kontrata në mes të palëve ka përfunduar.

#### *SATATUSI I PROJEKTIT MASAT SHOQERUESE-*

Për sa i përket projektit të Masave Shoqëruese faza 2 e cila ka konsistuar në asistencën teknike pas leshuarjes në operim të ITUN-se, kjo periudhë ka qenë e planifikuar në kohëzgjatje prej 18 muajsh duke filluar në janar 2020 dhe do të përfundojë në qershorë 2022.

Gjatë kësaj periudhe kjo konsulence ka zhvilluar këto aktivitete të parapara në kontratë:

- Mbikëqyrja dhe verifikimi i punëve të përfunduara,
- Mbikëqyrje e procesit të trajnimit,
- Monitorimi dhe trajnimi i stafit të laboratorit,
- Analiza e SCADA-es dhe hartimi i raporteve të sajë,
- Digjitalizimi i planit të mirëmbajtjes përmes MMS,
- Mbikëqyrja dhe kërkesat për optimizmin e ITUN.

Kontrata me konsulentët e Masave Shoqëruese DORSCH GROUP ka përfunduar me 30.06.2022, mirëpo nuk janë shfrytëzuar shërbimet opsionale të cilat i ka parapare kontrata.

Me datë 16.06.2022 kemi dërguar kërkesë në KfW për vazhdimin e kontratës me konsulentët e Masave Shoqëruese si vijon:

Sic diskutuam me datë 23 Maj 2022, dëshirojmë të kërkojmë miratimin tuaj për vazhdimin e kontratës Konsulentë e Masave Shoqëruese.

Në të kundërt Kontrata do të përfundojë me 30 Qershor 2022.

Ky vazhdim do të mbulojë çështjet në vazhdim:

Optimizmin i operimit të WWTP, efikasitetin e energjisë dhe masat për kursimin e kostos.

Përvetësimi i softuerit te nevojshëm për përdorimin e te dhënave nga SCADA te cilat mundësojnë manovrimin me eficient te veglës se implementuar për te dhënat historike ne SCADA.

Trajnime te mëtutjeshme për operim me Laborator.

Vazhdimi do te jete për 6 muaj (deri ne fund te Dhjetorit 2022).

Akoma janë disa mjete te rimbursueshme dhe shërbime opcionale te mbetura ne kontratën e Konsulences (optional services 1 and 3) qe do te shfrytëzohen për mbulimin e këtij adendumi.

Për me tepër, adendumi ka me formali ne tarifën e ndërprerjes ne vlere prej 8850 Euro për te cilën jemi pajtuar ne emalin e datës 04.06.2021.

KfW-ne e ka pranuar-miratuar kërkesën tone për mundësinë e zgjatjes apo shfrytëzimit te shërbimeve opsion ale qe parasheh kontrata me DORSCH GROUP.

Konsulenca Masat Shoqëruese do te përgatisin raportin tremujor qe mbulon periudhën Korrik-Shtator, te njëjtin do ta dërgojnë tek KfW dhe HRJ ne fund te muajit Tetor.

Jemi ne proces te shërbimeve nga konsulenca e Masave Shoqëruese dhe ne Muajin Tetor do te jene prezent ne Impiant përfaqësuesit e Dorsch group.

Për sa i përket adendumit nr.2 për konsulentët Masat Shoqëruese nga DORSCH GROUP i cili përfshin periudhën 01.07.2022 deri me 31.12.2022 ende nuk e kemi pranuar raportet Tremujore nga Dorsch, mbi bazën e te cilave do te përshkruhen te gjitha aktivitetet qe i përkasin kësaj periudhe.

#### **4.4 PROBLEMET E HASURA GJATË KËSAJ PERIUDHE**

- Probleme me furnizim te energjisë elektrike nga ana e KEDS,
- Mungese e stafit-(3 Roje, 1 punëtor fizik, 1 Punëtor mekanik, 1 Teknik te elektros dhe 1 mirëmbajtës), kërkesa është dorëzuar ne muajin Korrik-2022.

#### **4.5 MASAT E REALIZUARA / MOS REALIZUARA NGA PERIUDHA PARAPRAKE**

- E gjithë mirëmbajtja e planifikuar sipas MMS-it është realizuar ne afat te parapare,
- Te gjitha sanimet e defekteve emergjente janë sanuar me kohe,
- Janë riparuar 3 shtretërit e Llumit dhe e kanë kaluar testin sipas raportit te konsulences

- Janë zbatuar manualët si në operim si në mirëmbajtjes po ashtu edhe në mbrojtje dhe siguri në punë.

-Jemi duke e konsoliduar Departamentin e Ujërave të Ndotura në të cilin do të përfshihet edhe mirëmbajtja e sistemit të kanalizimit në nivel regjional dhe Autoparku bashkë me Oficinën punuese.

#### **4.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN NË VAZHDIM**

- Monitorimi i sistemit të kanalizimit dhe puse tave kapërderdhësve (Interceptoreve),
- Monitorimi i fazave të trajtimit për një cikël sa më efikas,
- Monitorimi i cilësisë së ujit në hyrje, pas dekantimit primar dhe në dalje,
- Vazhdimi i aktiviteteve në mirëmbajtjen e planifikuar sipas SOP Procedurave Standarde të Operimit
- Instalimi i kamerave për sigurimin e zonës së parë mbrojtëse,
- Efikasiteti në aspektin logjistik, furnizim me kohë me kemi kate për laborator,
- Efikasiteti në aspektin logjistik, furnizim me kohë me naftë dhe material fazonerik të nevojshëm për intervenime emergjente,
- Vazhdimësia e sigurisë dhe mbrojtjes në punë për stafin e ITUN-se dhe ndaj stabilimenteve punuese të ITUN-se,
- Kompletimi i stafit të nevojshëm për efikasitetin e punës në ITUN,
- Mirëmbajtje me efikasitet të hapësirës së ITUN-se pasi që është sipërfaqe shumë e madhe dhe nevojitet angazhim si në fuqi punëtore po ashtu edhe makinerie.
- Takimet me kryetaret e Komunave përkatëse në lidhje me:

Konsolidimin e sistemeve ekzistuese të kanalizimit dhe planifikimit të sistemeve të reja të kanalizimit.

Mundësia e marrjes në menaxhim të Impiantit në fshatin Kuk, komuna Dragashit dhe në fshatin Bukosh, komuna e Suharekës,

Mundësia e përpilimit të Master Planeve për zgjerimin e shërbimeve përmes sistemeve të reja të kanalizimit po ashtu edhe Impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura për secilën Komunë ku ofrojmë shërbime përkatëse.

-Në muajin Nëntor kemi zhvilluar një takim pune me drejtorin e Shërbimeve Publike z Qele Lama për mundësinë e hartimit të Master Planit për komplet sistemin e kolektimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura për qytetin e Prizrenit.



## V. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Departamenti i administratës gjatë këtij tremujori është marr me përgatitjen e raporteve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

Gjatë këtij tremujori janë përgatitur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dala nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Hidroregjioni Jugor" Sh. A, Prizren.

Pas përgatitjes së Procesverbaleve të Bordit, Komisionit të Auditimit, janë njoftuar të gjitha shërbimet (udhëheqësit) lidhur me Vendimet dhe rekomandimet e Bordit dhe raportet e kërkuara nga mbledhjet në fjalë.

Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga fusha e veprimtarisë së Kompanisë.

Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.

Nga zyra ligjore është bërë përfaqësimi i Kompanisë në Gjykatën Themelore të Prizrenit, Malishevës, Dragashit dhe Suharekës si dhe është punuar intensivisht në procedimin e lëndëve të përmbaaruesit privatë për secilën njësi punuese, lëndë këto që kanë të bëjnë me konsumatorët e amvisërisë dhe bizneset që kanë borxh ndaj shërbimeve të ujësjellësit.

Aktvendimet për pushime vjetore janë lëshuar pas kërkesës me shkrim të punëtorëve dhe aprovimin apo pëlqimin nga udhëheqësit e tyre.

Me autorizim të Kryeshefit Ekzekutiv janë përgatitur Vendime për mbikëqyrje të punimeve dhe pranim teknik për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave të njësive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.

Me Vendim janë formuar Komisionet për regjistrim vjetor 2022 që përfshin: Komisioni për regjistrimin e mjeteve themelore, veglave të rënda dhe inventarit të imët; Komisioni për regjistrimin e lëndëve të para dhe materialit në depon kryesore dhe në servis të bazhdarimit; Komisioni për regjistrimin e arkës, porto-arkën, kërkuesit dhe blerësit dhe Komisionin Qendror të regjistrimit. Të gjithë komisionet e regjistrimit do të kryejnë regjistrimin prej 29.12.2022 gjerë më 10.01.2023 dhe në fund do të kryhet barazimi me gjendjen e kontabilitetit dhe raporti do të dorëzohet komisionit qendror. Komisioni qendror është i obliguar të përpilojë raport mbi kryerjen e të njëjtës dhe t'ia dorëzojë Kryeshefit Ekzekutiv gjerë më 15.01.2023.

Nga udhëheqësit e departamenteve dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë të shërbimeve përkatëse të Kompanisë është bërë vlerësimi vjetor i performancës së secilit punonjës për kryerjen e detyrave të punës në Kompani gjatë viti 2022. Të gjitha vlerësimet e punonjësve për vitin 2022 janë regjistruar në dosjen e tyre në program Navision nga Zyrtarja për burimet njerëzore.

Janë bërë vazhdime te kontratave te punëtorëve te Kompanisë te cilët kane qene ne afat të caktuar për një vit. Vazhdimi kontratës së punës është bërë pas vlerësimit të punës së tyre nga ana e udhëheqësve te sektorëve përkatëse.

Nga Zyrtari për siguri në punë vazhdimisht është bërë kontrollimi i punëtorëve të shërbimit operativ për kujdesin në punë dhe respektimin e Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, gjatë realizimit të punimeve në eliminimin e defekteve në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit .

Gjatë vitit 2022 janë realizuar vizita/kontrolla të vazhdueshme brenda dhe jashtë orarit edhe nga Shefit të Sigurimit Fizik të Objekteve dhe Administrator i Rojës në kohë të pacaktuar nëpër të gjitha objektet të cilat sigurohen nga kujdestaret – roje gjatë 24/h, në Kompani.

Pjesmarrja ne Konferencën e ujit ne Prishtinë te organizuar nga SHUKOS-SHUKALB.

Pushimet e shfrytëzuara nga punonjësit gjatë TM-4/2022

Nr	Llojet e pushimeve	Ditët e shfrytëzuara
1	Pushim vjetor	128
2	Pushim mjekësor	46
3	Pushim pa pagesë	5
4	Ndwrrim tw pozitës sw punws	3
6	Pensionuar	4
7	Pushim për rast vdekje	4

Raport i numrit të punëtorëve Tetor - Dhjetor, 2022

Nr.	Muaji	Hidroregjioni Jugor	Prizren				Suharekë	Dragash	Malishevë
			Prizren	Bordi	ITUN	Total			
1	TETOR	331	222	6	16	244	36	16	35
2	NENTOR	331	224	6	16	246	35	16	34
3	DHJETOR	331	224	6	16	246	35	16	34

Numri i punëtorëve sipas departamenteve dhe mosha mesatare e punonjësve ne HRJ

DEP. Administratë	DEP. Financave	DEP. Teknik	DEP. Konsumator	DEP Itun	Nj. Suharekë	Nj. Malishevë	Nj. Dragash	Mosha mesatare HRJ
44	13	83	84	16	35	34	16	48

PERSONELI – TETOR– DHJETOR 2022

Muajt	Nr. i te punësuarve sipas muajve	Vende plotësuar	te Te larguar	Të pensionuar	Te tjera
Tetor	325	3	1	1	
Nëntor	325				
Dhjetor	325			3	

NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR- 2022

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH. A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Mysliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	285	32	3	5	325
Numri i Punëtorëve në %	87.7	9.8	0.9	1.5	100

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	47	14.46	
MESHKUJ:	278	85.54	
TOTAL	325	100.00	

## KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2022

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Doktoratur	Master	Fakultet	Bachelor	Sh. e mesme	Shkolla fillore	Pa shkollë	Gjithsejë
Nr. i punëtorëve	2	15	24	39	212	32	1	325
Kualifikimi në %	0.62	4.62	7.38	12.00	65.23	9.85	0.31	100.00

Ne baze te nenit 69, paragrafi 1 i Ligjit te punës Nr 03/L-212 i Republikës se Kosovës, e shkëput kontratën e punës me vet dëshirë punëtori:

A.Shala – me pozite te punës Ndhmës gjeodet ne GIS me datë 01.10.2022.

Nga konkurset e publikuar gjatë muajit korrik dhe gusht 2022 janë punësuar 3 punëtor ne kompani gjatë TM4, ne njësinë e Prizrenit.

## PËRFAQËSIMI NË GJYKATA TETOR – DHJETOR 2022

Muaji	Seanca përgatitore	Seanca kryesore	Seanca të shtyra	Ndërmjetësim	Vërejtje
Tetor	/	3	1	3	
Nëntor	/	2	1	/	
Dhjetor	1	2	1	1	
Totali	1	7	3	4	

## ARDHJET NGA GYKATA DHE INSTITUCIONET TJERA

## TETOR – DHJETOR (TM4)

	Tetor	Nentor	Djetor	Totali
Aktvendime me provime të pjesërishme	14	4	5	23
Aktvendime në favor të Kompanisë	/	/	/	/

Aktvendime kundër Kompanisë	1	/	/	1
Caktimi i përfaqësuesve të përkohshëm	/	/	/	/
Thirrje për seanca gjyqësore, ndërmjetësim etj.	2	3	2	7
KALLZIMET PENALE				
Aktvendime për Kallëzime Penale kundër Kompanisë	/	/	/	/
Aktvendime me ndërmjetësim të Kallëzimeve Penale	/	/	/	/
Kallëzime Penale nga ana e Kompanisë	/	6	/	6
TË TJERA				
Njoftime për hedhje dhe Kërkesa	/	/	1	1
Urdhëresë për pagesë të Garancisë	/	/	/	
Pagesë të Taksës Gjyqësore	1	/	/	1

LËNDËT TË CILAT JANË NË PROCEDURA GJYQËSORE DHE TË CILAT E KËRCËNOJNË KOMPANINË

Nr.	C.nr.	Kontesti	Vërejtje
1	C. nr. 116/03, datë 08.05.2013	Padi për kompensim dëmi.	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
2	C.nr. 286/14, datë 03.06.2015	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë
3	C.nr. 170/18, datë 14.09.2018	Padi – kompensim dëmi	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
4	C.nr. 471/2017, datë 06.10.2017	Padi – kompensim dëmi	Nga Gjykata e Apelit lënda është kthyer në Gjykatën Themelore të Prizrenit në rigjykim dhe rivendosje

5	C.nr. 416/18, datë 24.05.2018	Padi – Kontest pronësor	Gjykata Themelore e Prizrenit me Aktgjykim e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe tani Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
6	C.nr. 99/16, datë 06.03.2018	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Dragash
7	C.nr. 364/16, datë 12.10.2016	Padi – Kontest pronësorë	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren – dega Suharekë
8	C.nr. 745/05	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
	05.09.2005		
	C.nr. 68/17 (Nr. i ri)		
	08.10.2015		
9	C.nr.1902/2019	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë.
10	C.nr.251/20	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
11	C.nr. 1030/20 27.07.2020	Padi – Kontest nga marrëdhënia e punës	Lënda gjendet në Gjykatën E apelit në Prishtinë
12	CP. Nr. 1024/20 19.01.2021	Propozim për përmbarim	Në Gjykatën Themelore në Prizren
13	C.nr.363/20	Padi për anulim të Vendimit Nr.930/20	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë
14	C.nr.1714/19	Padi – kompensim dëmi material dhe jo material	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
15	C.nr.504/19	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren-Dega në Suharekë

16	C.nr.239/18	Padi për kompensim dëmi	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Prizren
----	-------------	-------------------------	--

## Paditë e ushtruara nga Kompania

1	J. Sh. F. Banjë Malishevë	Padi sipas Aktgjykimit P.nr.313/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Gjakovën-Dega në Malishevë
2	N.T.P. Krasniqi,	Padi për kompensim dëmi	
3	Y. Sh., F. Banjë Malishevë	Padi sipas Aktgjykimit P.nr.312/18	Lënda gjendet në Gjykatën Themelore në Gjakovën-Dega në Malishevë
4	Padi ndaj ATK-së, Prishtinë	A.nr.902/2020	Gjykata Themelor në Prishtinë
5	A.nr. 1648/20, 19.11.2020	Padi për Inicimin e Konfliktit Administrativ	Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti Administrativ

## PROCEDURA PËRMBARIMORE

	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
NJËSIA PUNUESE PRIZREN				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	1	62	17	80
PRAPËSIME	3	2	7	12
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	3	2	7	12
MARRËVESHJE	31	15	21	67
TË PËRFUNDUARA	18	20	9	47

ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	1	1
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	1	1
NJËSIA PUNUESE SUHAREKË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	7	7
PRAPËSIME	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	/	/
MARRËVESHJE	/	/	1	/
TË PËRFUNDUARA	/	1	/	1
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	1	1
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	1	/	/	/
NJËSIA PUNUESE MALISHEVË				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	/	/
PRAPËSIME	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË PRAPËSIME	/	/	/	/
MARRËVESHJE	2	/	/	2
TË PËRFUNDUARA	/	/	/	/
ANKESË NË GJYKATËN E APELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/
NJËSIA PUNUESE DRAGASH				
PROPOZIME PËR PËRMBARIM	/	/	/	/



PRAPËSIMË	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË PRAPËSIMË	/	/	/	/
MARRËVESHJE	/	/	/	/
TË PËRFUNDUARA	/	2	1	3
ANKESË NË GJYKATËN E AELIT	/	/	/	/
PËRGJIGJE NË ANKESË	/	/	/	/
TËRHEQJE	/	/	/	/
ME PËRFAQËSUES	/	/	/	/

### PROBLEMET GJATË PROCESIT TË PUNËS

Vazhdojnë të jen problem lëndët e lartcekura të cilat e kërcënojnë Kompaninë, kemi lëndë që kanë të bëjë me kontest nga marrëdhënia e punës, lëndë që kanë të bëjnë kompensim dëmi, kontest pronësor dhe kontest lidhur me borxhin e ujit .

Gjatë procesit të punës Zyra Ligjore ballafaqohet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër të cilat mundë ti përmendim:

Ligjin mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, respektivisht Neni 360, Paragrafi 1, Nënparagrafi 1.1, e parasheh afatin njëvjeçarë të parashkrimit për ujë të pijes, me ç`rast kompanisë po i shkakton dëme të konsiderueshme materiale, pasi që gjykata në shumicën e Vendimeve të cilat po i merr po thirret pikërisht në këtë dispozitë, ndërsa kompania për këto borxhe ka qenë e ngarkuar dhe ka paguar TVSH.

Deri te përmbartimi i lëndës përmbartuesi has në probleme të ndryshme duke filluar nga gabimet në evidentimin e konsumatorëve, ku në propozim për përmbartim figuron emër tjetër, ndërsa shfrytëzues i shërbimeve të ujit është person krejt tjetër.

Mungesa e numrave personal gjithashtu ndikon në vonesa për përmbartimin e lëndëve.

Pasaktësia e adresave të vendbanimit të konsumatorëve gjithashtu ndikon në vonesa për përmbartimin e lëndëve.

Faturimi në emra të vdekurve, sjellë humbje kohe dhe probleme tjera përcjellëse, pasi që të njëjtëve duhet të ju caktohen përfaqësues të përkohshëm.

Kyçjet ilegale të konsumatorëve për kompaninë janë të kushtueshme, mirëpo Vendimet e gjykatave në aspektin e disiplinimit të konsumatorëve kanë dhënë rezultate pozitive edhe pse ato ende janë rezultate fillestare.

Rastet sociale të konsumatorëve gjithashtu na paraqesin problem, sepse neve jemi të detyruar që ti tërheqim propozimet për përmbartim kur bëhet fjalë për rastet e rënda sociale, e që shpenzimet për taksat e përmbartimit bien mbi kompaninë.

### Propozim për zgjidhjen e problemeve

Sipas Zyrës Ligjore për tu zgjidhur problemet e lartcekura, nevojitet angazhim i të gjithë punonjësve dhe në veçanti angazhimi i lexuesve pasi që janë në kontakte të rregullta me konsumatorët. Faktori kryesor përgjegjës për ti ikur parashkrimit të borxheve ndaj kompanisë do të ishte që të njëjtit të i bindin konsumatorët që të paguajnë të paktën një pagesë nga borxhi i krijuar brenda vitit kalendarik nga konsumatori, ndërsa sa i përket eliminimit të problemit lidhur me konsumatorët e vdekur, ne propozojmë se zgjidhja më e mirë do të ishte shkyçja nga rrjeti i ujësjellësit nëse pasardhësi nuk pranon të kaloj borxhi në emër të tij.

### PUNËT E REALIZUARA NGA TM PARAPRAK

Vlerësoj se Departamenti Administrativ ka bërë një përmbyllje të kënaqshme të TM4-2021, janë realizuar të gjitha obligimet ligjore të parapara në detyrat e punës si përgjegjësi kryesore dhe në statutin e Kompanisë.

Janë respektuar Politikat e Kompanisë për Procedimin për Përmbarim të Borxheve të Konsumatorëve të cilët nuk i paguajnë faturat e tyre ndaj Kompanisë për shërbimet e ofruara , për Arkëtimin e të gjitha faturave të pakontestueshme për shërbimet e ofruara.

### SYNIMET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Synim i Departamentit Administrativ është përcjellja dhe zbatimi i të gjitha ligjeve dhe ndryshimeve eventuale që kanë të bëjnë me funksionalizimin sa më të mirë të kompanisë.

Mbetet që në vazhdimësi të punohet në Përpilimin e rregulloreve të nevojshme, për rregullimin e politikave dhe procedurave të përgjithshme të KRU“Hidroregjioni Jugor“Sh. A, duke u bazuar në nevojën për suksesin e mbarëvajtjeve të punëve në Kompani si dhe propozimeve të dala nga Menaxhmenti ,Bordi I Drejtorëve dhe Aksionari-Qeveria e Republikës së Kosovës.

Përfaqësim sa më të mirë në Gjykatë dhe Institucionet kudo që do të paraqitet nevoja.

Të vazhdojmë me nxjerrjen e Akteve të reja, korrigjimet, eventuale të Akteve ekzistuese ku vërejmë se ka vend për intervenime, pastaj të bëjmë ndryshime dhe plotësime të Akteve të brendshme të Kompanisë sipas kërkesave Ligjore.

## VI. RAPORT I AUDITORIT TË BRENDSHËM

Raporti në vijim paraqet përmbledhjen dhe prezentimin e punëve dhe aktiviteteve të auditorit të brendshëm, të realizuara gjatë tremujorit të katërt të këtij viti (TM4/2022), gjegjësisht raport i punës për periudhën kohore tetor – dhjetor 2022.

Duhet theksuar se në pajtim me planin vjetor të punës së auditimit për vitin 2022, si dhe bazuar në kërkesën shtesë për auditim, janë realizuar auditime në subjekte të ndryshme brenda kompanisë, sikurse janë auditimet lidhur me:

- Menaxhimi i procesi të faturimit të konsumatorëve Abi-Elif 19 dhe Galeria Shop.Mall;
- Menaxhimi i procesit të borxhit të KEK - mos respektimi i kontratës për falje të borxhit;
- Menaxhimi i procesit lidhur me lëndën gjyqësore të largimit nga puna, të punonjësit R.H;
- Menaxhimi i procesit të rekrutimit të punonjësve për pozitat arkatare dhe punëtorë në bazhdarim, në NJP Prizren;
- Menaxhimi i procesit të faturimit dhe të inkasimit në NjP në Malishevë;
- Menaxhimi i procesit të faturimit dhe të inkasimit në NjP në Suharekë;
- Menaxhimi i procesit të faturimit dhe të inkasimit në NjP në Dragash;
- Menaxhimi i procesit të inkasimit në shërbimin me konsumatorë në NjP në Prizren DRK;
- Menaxhimi i transportit procesi i përdorimit të automjeteve zyrtare në ITUN/ KRU HRJ;
- Menaxhimi i procesit të dhënies së pëlqimeve dhe lejeve për kyçje;

Pas përfundimit të auditimeve, në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm është bërë:

përgatitja e draftraporteve,

mbajtja e takimeve me subjektet e audituara,

diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe finalizimi i raporteve.

Duke u bazuar në testimet e kryera dhe të gjeturat e auditimeve të kësaj periudhe tremujore, është konstatuar se në përgjithësi menaxhimi i proceseve është kryer:

në pajtim me dispozitat ligjore,

është treguar një performancë e mirë e shërbimeve, si dhe

është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

Gjatë auditimit të disa proceseve, janë konstatuar edhe mangësi, ku dhe janë dhënë rekomandime të cilat mbeten të realizohen. Detajisht janë të prezentuara në raportet finale të këtyre auditimeve, të cilat i janë bashkangjitur këtij raporti.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është bërë rishikimi i adresimit të rekomandimeve të auditimeve të realizuara gjatë periudhës kohore TM3/2020, gjegjësisht periudhës tremujore korrik – shtator 2020.

## VII. AKTIVITETET E PROKURIMIT – TM4 2022

Titulli i kontrates	Nr.Prokurimit	Data e nenshkrimit	Data e skadimit	Operatori Ekonomik	Vlerat e kontrates
"FURNIZIMI ME ELEKTROPOMPA DHE PAISJE KOMANDUESE" - LOT I A Elektromotori dhe pompa centrifugale- B- Pompa centrifugale pa elektromotor LOT II C - Elektromotori dhe pompa zhytëse (CILINDRIKE) LOT III D - INVERTERET (RREGULLATORET) FREKUENTOR - E - Paisjet për lëshim të butë në punë – SOFT STARTERËT LOT IV F - Paisjet për komunikim dhe dirigim nga distanca "Stacion i pompimit – rezervuar" dhe ngjajshëm	HJ-22-020-111	30.11.2022	29.11.2025	LOT II C - Elektromotori dhe pompa zhytëse (CILINDRIKE)  NPSH HITERM-EL	LOT II- 150,000.00€
	HJ-22-020-111			LOT IV F - Paisjet për komunikim dhe dirigim nga distanca "Stacion i pompimit – rezervuar" dhe ngjajshëm  "ENELDAT" SHPK	6,900.00€
LOT I:Furnizim me printer mobil per shtypjen e faturave	<b>HJ-22-021-121</b>	23.09.2022	30 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes	InterAdria L.L.C	34,935.00€
LOT II:Furnizim me telefona te mencur per shtypjen e faturave	<b>HJ-22-021-121</b>	22.09.2022	30 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes	"Infinit" SHPK	8,783.50€
<b>Furnizim me karburant</b>	<b>HJ-22-022-136</b>				<b>(Anular)</b>
Titulli Shpallje ne media LOT I Televizion lokal Prizren 1 LOT II Televizioni lokal Prizren 2 LOT III Radio lokale ne gjuhen shqipe Prizren LOT IV Radio lokale ne gjuhen Boshnjake Prizren LOT V Radio lokale Suhareke LOT VI Radio lokale Malisheve	HJ-22-024-225	20.09.2022	16.09.2025	LOT I:Radio Televizioni " Besa"	9 000,00 €
		20.09.2022	16.09.2025	LOT II:TVPz - TV Prizreni	9 000,00 €
				LOT III:	Eshte anuluar ne mungese te ofertuesve
		20.09.2022	16.09.2025	LOT IV:P.T.U. " Omega - 3 "	2 880,00 €

LOT VII Radio lokale Dragash		22.09.2022	16.09.2025	LOT V:Media Center VALA SH.P.K.	2 880,00 €
		22.09.2022	16.09.2025	LOT VI:N.P.SH.RADIO "MALISHEVA"	2 880,00 €
		22.09.2022	16.09.2025	LOT VII: RADIO LOKALE DRAGASHI	2,880.00€
Rehabilitimi I rrjetit te ujesjellesit ne rruget Vjosa, Maria Kraja, Hajdin Rrahmanaj, Sarajeva dhe Shkodra-Prizren	<b>HJ-22-025-521</b>	02.11.2022	Brenda 3muaj nga koha e leshimit te urdherblerjes	Grupi I Operatoreve Ekonomik NNSH CO-ING; P.M.N SHPK Kroj I Bardhe Prishtine	104,500.00€
<b>Furnizim me Klor Gas dhe Hipoklorit Natriumi-</b>	<b>HJ-22-026-121</b>	25.11.2022	25.11.2023	Afrim Sadriu B.I	84,666.00€
<b>Ritender Kyçjet dhe shtëpiake dhe rehabilitim i rrjetit të ujësjetësimit- Fshati Peqan .</b>	<b>HJ-22-027-521</b>	16.02.2022	Brenda 2 muajve	"V-SHEHU" SHPK	52,276.30€
Furnizim me paisje te fotokopjeve ekzistuese dhe sertesimi I tyre.	<b>HJ-22-028-136</b>	24.10.2022	30 dite nga koha e leshimit te urdherblerjes	"Infinet" SHPK	2.885.60€
<b>Auditimi i jashtem per vitin 2022,2023,2024</b>	<b>HJ-22-029-221</b>	24.11.2022	24.11.2024	Nsh "Audit&Conto" SHPK	6,867.60€
<b>Ritender : Shërbime të veçanta : Kontabilist i Çertifikuar</b>	<b>HJ-22-030-236</b>	05.01.2023	31.03.2023	Emin Sylejmani	590.00€
Mirembajtja dhe avansimi I softverit	<b>HJ-22-031-225</b>	04.11.2022	04.11.2025	ASSECO SEE SHPK	84,065.40€

Shtrirja e rrjetit te ri te ujesjellesit ne lagjen Landovice	<b>HJ-22-032-521</b>	24.11.2022	Brenda muajve	2	Grupi Operatoreve Ekonomik NNSH "CO-ING" "Hidro Project" SHPK	46,005.80€
Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësllësit duke përfshir edhe vendosjen e ujëmatësave jashtë pronës private në rrugën "Zek Bajraktari" - Suharekë.	<b>HJ-22-033-521</b>	12.02.2022	Brenda muajve	3	"Muratori" SHPK	64,450.30€
Dezinfektimi, Deratizimin dhe Deinsektimin (DDD) i objekteve të KRU Hidroregjioni Jugor dhe Impijantit te Ujrave te Ndotura-ITUN.	<b>HJ-22-034-221</b>	09.12.2022	09.12.2025		Samire Osmani P.N	0.09€
<b>Furnizim me lend djegese (dru bungu)</b>	<b>HJ-22-035-136</b>	05.12.2022	Brenda muajve	1	Ndermarrja Tregtare Sherbyese "TINI"	3,863.50€
<b>Furnizim me Rrobe Pune per Punetor</b>	<b>70433702-22-12523-121</b>	27.12.2022	27.12.2023		"PUNTEX" SHPK	55,550.70€
<b>Sigurimi(TPL) automjeteve zyrtare</b>	<b>70433702-22-12564-236</b>	23.12.2023			Kompania e Sigurimeve EUROSIG SH,A	6,067.74€

ORGANOGRAMI

Organogrami i KRU "Hidroregjioni Jugor", Sh. A

